REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS

Procesverbal

Konsultim publik : Takim me Personat me Aftësi të Kufizuara (PAK)

Data : 23.05.2025 **Ora** :11.00 **Vendi**: Pranë Qendrës Komunitare për Shërbime me PAK

Numri i pjesëmarrësve : totali 23; nga të cilët 15 gra dhe vajza, 8 meshkuj (sipas listës bashkëlidhur)

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet: **"Tavanet Buxhetore te Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028"**

Pjesëmarrës: Janë pjesëmarrës nga këshilli bashkiak Prrenjas: Kryetari i Këshillit Bashkiak **Medi Hana**, **Leonard Ozuni dhe Luan Karriqi** nga bashkia Prrenjas Drejtori i Financës **Suzana Kapxhiu,** Sekretari i Këshillit **Klajdi Lufo**, Koordinator i Bashki Të Forta **Naim Çope,** Koordinator për Njoftimin dhe konsultimin publik **Rudina Kukli**; dhe grupe të interesit.

Gjatë këtij takimi Drejtoresha e Financës Suzana Kapxhiu foli për të gjithë pjesëmarrësit për Tavanet Buxhetore, prioritetet dhe vëmendjen që do ti jepet "Qendrës Komunitare për Shërbime ndaj Aftësisë së Kufizuar". Ka qenë projekt i cili ka qenë bashkëfinancim me bashkinë Prrenjas, tashmë ka kaluar i kalon bashkisë të menaxhojë qendrën. Bashkia Prrenjas do t'ju kushtojë vemendje Qendrës duke shtuar numrin e shërbimeve si edhe trajnimit të një stafi të kualifikuar dhe të përkushtuar. Jemi krenarë që kjo qendër është ndër rastet model në të gjithë qarkun duke trajtuar rreth 180 të rinj me PAK por jo vetëm kaq por ofrohet edhe shërbimi lëvizës për raste të veçanta edhe në zona të thella të bashkisë. Jemi krenar për stafin që është i përkushtuar dhe do të bëjmë maximumin tonë që ta mbajmë këtë staf.

Kryetari i Këshillit **Medi Hana** shtoi gjatë këtij takimi se nga ana e këshillit bashkiak Prrenjas do të bëhet maksimumi që kjo Qendër të vijojë punën me të gjitha kushtet optimale duke rritur ofrimin e shërbimeve dhe garantim të ofrimit të shërbimeve cilësore. Gjithashtu theksoi se ne si këshill duhet tu bëjmë thirrje gjithë bizneseve të zonës për të na mbështetur më tepër për familje në nevojë.

Fabiola Komici shpreh mirënjohjen për punën që bën stafi dhe ngre shqetësimin se si do të veprohet me fëmijët të cilët do ta kalojnë moshën dhe sdo jenë më pjesë e Qendrës, të njëjtin shqetësim ka edhe **Avni Laraku.**

Mikel Latollari jep rekomandimin që në Qendrën e Shërbimeve të bëhet një shtim të numrit të shërbimeve që ofron qendra.

Leonard Ozuni anëtar i këshillit thekson se do ta ngrejë zërin e tij në këshill që projekti i Qendrës me PAK të vazhdojë dhe ti jepet gjithë ndihmesa e duhur për mirëfunksionim.

Mikeli dhe Leonardi dhanë rekomandimin që së bashku prindërit e personave me PAK dhe Këshilli Bashkiak Prrenjas të marrin nismën që të mbledhin firmat dhe t'ia drejtojnë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për shtim shërbimesh në këtë qendër.



